

Elbasan më: 08.09.2025

**STATUTI
DHE
AKT THEMELIMI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Digital Creativity” Sh.p.k.**

**KREU I
HYRJE**

Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Digital Creativity” Sh.p.k.** është themeluar nga ortakët:

1.Eraldo Cano , i datëlindjes **07.05.1994**, lindur në **Ersekë, Shqipëri**, person madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Numër. Personal **J40507064W**, dhe numër Pasaporte **BB0306366**

Themeluesi, i cili është madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin hartoi edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

**KREU II
PERKUFIZIME**

Neni 2

Emërtimi i shoqërisë

Emërtimi i Shoqërisë është **“Digital Creativity” Sh.p.k.**

Neni 3

Asambleja e ortakëve ka vendosur miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Gjithashtu shoqëria e bazon aktivitetin e saj në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, në Kodin Civil dhe Kodin e Punës si dhe në ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë.



Neni 4

Forma

Shoqëria **"Digital Creativity" Sh.p.k.** është "Shoqëri me Përgjëgjësi të kufizuar" Sh.p.k.

Neni 5

Selia

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Elbasan , Rruga "Zef Kadarja" pallati 731, kati 4 ,apartamenti 10.
2. Shoqëria ka të drejtë të hapi filiale të tjera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në varësi të selisë Qëndrore që ndodhet në **qytetin e Elbasanit**.
3. Vendi i mbajtjes së mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme është selia e shoqërisë. Nëse bihet dakord me unanimitet mbledhjet e Asamblesë mund të kryhen në një vend tjetër.

Neni 6

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

1.Zhvillim software dhe IT.

- Zhvillim software ne te gjitha platformat (web, desktop, mobile), duke perfshire analizen, dizajnin, planifikimin, implementimin dhe mirembajtjen.
- Programim dhe shitje e programe software, shitje licencash per programed he antivirus(firewall).
- Dhenie konsulencash per projektimin, implementimin dhe mirembajtjen e programeve informatike.
- Zhvillim sistemesh migrimi dhe permiresim/upgrade te sistemeve informatike.
- Operim, menaxhim, support, trajnime dhe auditim teknik/informatik per sisteme software.

2. Data storage, Networking dhe Infrastruktura IT.

- Projektim , implementim dhe mirembajtje te infrastruktures se te dhenave (data storage).
- Rrjete kompjuterike (networking), perfshire servera , kabinete rrjeti, switching, routing, firewall dhe pajisje te ngjashme.



- Instalim dhe mirembajtje e servereve, sistemeve te virtualizimit dhe dhomave te serverave.
- Pajisje sigurie dhe monitorimi, perfshire sisteme kamerash dhe pajisje te tjera te lidhura me sigurine elektronike.

3. Sherbime konsulence dhe trajnime

- Sherbime konsulence dhe trajnime ne fushen e teknologjise se informacionit.
- Konsulence ne fushen e zhvillimit software, sistemeve informatike, infrastruktures se rrjeteve, sigurise dhe menaxhimit te te dhenave.
- Trajnime dhe kurse profesionale ne fushen e teknologjise se infomacionit dhe sistemeve te komunikimit.

4. Import dhe Eksport

- Import,Eksport, tregti me hsumice dhe pakice per pajisjet kompjuterike, servera, pajisje rrjeti, pajisje elektronike, eletriike dhe industrial qe kane te bejne me sherbimet IT.
- Shitje dhe instalim i pajisjeve te sigurise elektronike (kamerat e vezhgimit, firewall, sistemet e kontrollit te aksesit).

5. Sherbime Marketingu(publicitet, reklama, botime , media) dhe Media Digjitale.

- Sherbime komunikimi dhe marketing, perfshire reclama, maredhenie me publikun dhe promovimin e shitjeve dhe eventeve.
- Pergatitje , prodhim dhe mirembajtje faqesh internet dhe mediash sociale, menaxhim i fushatave reklamuese online.
- Grumbullim te dhenash dhe statistika(sondazhem, testim tregu dhe analize tregu)

Neni 7

Vula e shoqërisë

1. Shoqëria ka vulën e saj, në brendësi të së cilës shkruhet i plotë emërtimi i shoqërisë dhe forma e saj juridike.
2. Të gjitha aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulën e shoqërisë.

Neni 8

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Përgjithshme.

Neni 9

Veprimet e lejuara të shoqërisë

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë Asambleja e Përgjithshme me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit.

Neni 10

Marrëdhëniet e punës

1. Shoqëria për të kryer veprimtarinë e saj sipas objektit të këtij statuti do të lidhe kontrata individuale për të rregulluar marrëdhëniet e punës.
2. Kontratat e punës do të lidhen konform ligjit "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" dhe dispozitave të tjera ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

KREU III

PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKERISË

Neni 11

Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur

1. Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë tregtare, nëse nuk deklarohen kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej të gjithë ortakëve ose të gjithë ortakëve të tjerë.
2. Cdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njoftohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
3. Miratimi i parashikuar jepet, gjithashtu, për çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë, apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipërm janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë:

- a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit/bashkëshortes;
 - b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
 - c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
 - d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.
- 4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorum.
 - 5. Çdo veprim që kërkon miratim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecursisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë.
 - 6. Për efekt të këtij statuti, me persona të autorizuar për të përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë tregtare do të kuptojmë ortakët e shoqërisë, administratorin, ekspertin kontabël të autorizuar dhe likuiduesin e shoqërisë.

Neni 12

Parimi i besnikërisë

- 1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët.
- 2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose nga ky statut, në rrethana të njëjta, ortakët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

Neni 13

Ndalimi i konkurrencës

- 1. Personat e autorizuar për të përfaqësuar ose mbikëqyrur shoqërinë tregtare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
- 2. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar.
- 3. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, të mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.



4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
 - a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
 - b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
 - c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.
5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:
 - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
 - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
 - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

KREU IV

KAPITALI THEMELTAR - PJESEMARRJA

Neni 14

Kapitali i shoqërisë dhe kuotat

1. Kapitali i shoqërisë ka vlerën 150 000 lekë i cili përbëhet nga 1 kuotë.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njejtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal që lejon ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 15

Kontributet

Kapitali i shoqërisë, zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë, si vijon:

1. Ortaku **Eraldo Cano** zotëron 100 % të vlerës së kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë, me vlerë prej 150 000 lekë;

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakut të vetëm si më sipër.

Neni 16

Kalimi i kuotave te kapitalit

1. Kuotat e kapitalit te shoqërise jane të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe te kalueshme ne rruge trashegimie. Trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi, bëhën ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund t'u kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit.
3. Në rast kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërise tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë. Kur ortakët që gëzojnë të drejtën e parablerjes kanë dyshime rreth çmimit të kuotave të ortakut që kërkon ti kalojë ato, mund ti drejtohen gjykatës që të caktojë një ekspert vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave tek të tretet duhet të lajmërohet në një afat sa më të shpejtë, nëse brenda 4 javëve ortakut nuk i jepet një përgjigje atehere presumohet se ortakët e tjere kane rene dakord qe kuotat e tij mund ti kalohen te treteve.
4. Kalimi i kuotave do te behet me kontrate.
5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

Neni 17

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

KREU V

ORGANET E SHOQERISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE

Neni 18

Asambleja e përgjithshme

1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Përgjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose nje person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë

autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqesimi i nje ortaku nga nje ortak tjetër apo administratori i shoqërisë).

3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tillë, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do të bëhet me shkresë, ose nëpërmjet postës elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë të procedojë sipas ligjit në fuqi "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare":
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
9. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
 - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
 - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të shoqërisë;
 - c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
 - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
 - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit perkates);
 - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investime;
 - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja përgjithshme vendos me shumicë të zakonshme për çështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave dhe vendimet merren me më shumë se gjysmën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
15. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicë të kualifikuar për çështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe çdo çështje tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme bëhet vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 70% e kuotave janë pranishëm, votojnë me shkrese apo mjete elektronike. Në këtë rast vendimet merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës.
16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë pikë, të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 19

Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizike të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në çdo kohë.



3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese se përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

Neni 20

Kompetencat e administratorëve

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 21

Emerimi i pare i administratorëve

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare emërohet ortak **ERALDO CANO**

KREU VI

VOTA

Neni 23

E drejta e votes

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.



Neni 24

E drejta për të kaluar rezolute

Asambleja e përgjithshme mund të miratojë rezolute pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratohet një rezolutë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të jenë të pranishëm të gjithë ortakët personalisht dhe ta votojnë atë në menyrë të unifikuar.

KREU VII

MARRREDHENIET FINANCIARE

Neni 25

Viti financiar

Çdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 26

Bilanci vjetor

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme e zakonshme.
2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.
3. Gjuha që përdoret në hartimin e dokumentave vjetore është gjuha shqipe.

Neni 27

Dividentet

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin në raport me kuotat që gjithsecili ka në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me kuotat, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 28

Marrëdhëniet me bankat dhe institutet financiare

Shoqëria ka të drejtë të hap llogari likuiduese pranë një ose më shumë bankave ose institucioneve financiare dhe të mund të kryejë veprime likuiduese pranë bankave. Në keto banka ose institute financiare si nënshkrim i parë do të depozitohet ai i administratorit të shoqërisë, i cili duhet të nënshkruaj për të gjitha veprimet financiare në emër e për llogari të shoqërisë. Ai mund të autorizojë edhe persona të tjerë brenda shoqërisë.

Neni 29



Marrëdhënia me organet tatimore

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron me 31 dhjetor të çdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklarin e të ardhurave, dhe ti depozitojnë ato pranë organit përkatës të tatimeve.

KREU VIII

NDRYSHIMI I STATUSIT TE SHOQERISE

Neni 30

Prishja e shoqërisë

1. Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
2. Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarët e radhes së parë të ortakut që vdes.

Neni 31

Likuidimi

1. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likuidues, i cili i paraqet asaj raportin e likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tij.
2. Në fund të procesit të likuidimit asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e kuotave të kapitalit mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe për mbylljen e procesit të likuidimit.
3. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kuotave të kapitalit tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

Neni 32

Shndërrimi i shoqërisë

Shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve.

KREU IX

DISPOZITA TE TJERA

Neni 33

Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Neni 34

Për çështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky statut nënshkruhet nga themeluesi.

THEMELUESI I SHOQËRISË

ERALDO CANO

ERALDO CANO

